



Pranuar / Dorezuar Prilijeno / Prodato Received / Delivery	11 - 12 2023	3 viti god year	
Organ / Njesia Organ / Jedinica Org. / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHAK	7416/2023		17



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.1283/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Arben Mehmeti dhe Malsore Gashi Bajraktari, anëtarë, me Çlirim Zeka-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës A.nr.1283/2023, të datës 13.10.2023, të parashtruar nga grup ankuesish, të cilat me autorizim i përfaqëson kundër Vendimit nr.164/2023, të datës 25.09.2023, të Zëvendësuesit të Drejtorit të Agjencisë së Menaxhimit Emergjent-Ministria e Punëve të Brendshme, në çështjen juridike “Kompensim Material”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 11.12.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar** ankesa me numër A.nr.1283/2023, e datës 13.10.2023, e parashtruar nga ankuesit
- II. Shfuqizohet** Vendimi me numër 164, i datës 25.09.2023, i Zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Menaxhimit Emergjent.
- III. Obligohet** Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Brendshme, që në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi, ankuesve si në pikën I të dispozitivit, t’i u njoh të drejtën e kompensimit për funksionin shtesë lidhur me angazhimin në Komisionin Qendror për Vlerësimin e Dëmeve, i themeluar sipas Vendimit Nr.14/99 të datës 30.09.2023 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, përfshirë edhe kompensimin në mënyrë retroaktive nga data 06.02.2023.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

Arsyetim

Ankuesit

të cilët me autorizim i përfaqëson si përfaqësues i përbashkët (*tutje referuar ankuesit*), me datë 13.10.2023 kanë parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit Nr.164/2023 të datës 25.09.2023, të Zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Menaxhimit Emergjent, në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, me pretendimin së ankuesit si anëtarë të Komisionit Qendror për Vlerësimin e Dëmeve i themeluar sipas Vendimit nr.14/99 të datës 30.09.2022 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, kanë të drejt në kompensimin për funksione shtesë siç përcaktohet me Rregulloren (QRK) Nr.10/2023 për Kompensimin për Funksionin Shtesë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*me tej Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullosës Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 16.10.2023 ka procedura kërkesën për përgjigje në ankesë në Agjencinë e Menaxhimit Emergjent, ndërsa, kjo e fundit, më datë 24.10.2023, ka përcjell përgjigje në ankesë së bashku me provat e lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 6533/2023 të datës 13.10.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mail nga K.L. për G.S. i datës 12.10.2023; Vendim me numër nr. 14/99 i datës 30.09.2022 i Qeverisë së Republikës së Kosovës; Qarkore rreth zbatimit të Rregullosës (QRK) Nr.10/2023 për Kompensimin për funksionin shtesë me numër reference 356/2023 i datës 22.03.2023; E-mail nga K.L. për E.H. etj. i datës 27.09.2023; E-mail nga A.L. për K.L. i datës 27.09.2023; E-mail nga K.L. për A.K. etj. i datës 27.09.2023; E-mail nga K.L. për Sh.A. i datës 15.09.2023; E-mail nga K.L. për Sh.A. i datës 20.06.2023; Vendim i KPMSHCK me numër protokollit 6019/2023 i datës 08.09.2023; Vendim i Zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Menaxhimit Emergjent me numër nr.164/2023 i datës 25.09.2023; Kërkesë për përgjigje në ankesë i datës 16.10.2023; Përgjigje në ankesë i datës 24.10.2023; Kërkesë për procedim të pagesës për kompensimin për funksionin shtesë me numër protokollit 42 i datës 25.04.2023; Akt Emërim i K.L. me numër Nr.210/2023 i datës 08.06.2023; E-mail nga V.G. për C.Z. i datës 22.11.2023; E-mail nga K.L. për V.G. i datës 22.11.2023; Akt Emërim i I.Sh. me numër protokollit 04-112-274 i datës 04.04.2012; Akt Emërim i B.M. i datës 02.10.2017; Ndryshimi dhe Plotësimi i Aktit të Emërimit i S.L. i datës 13.11.2018; Akt Emërim i E.H. me numër protokollit 58 i datës 04.01.2017; Ndryshimi dhe Plotësimi i Aktit të Emërimit i F.S. i datës 04.11.2016; Kërkesa për lëshimin e kartelës identifikuese i F.S. i datës 04.11.2016; Akt Emërim i P.B. i datës 12.03.2012; Ndryshimi dhe Plotësimi i Aktit të Emërimit i G.S. i datës 13.05.2019; E-mail nga C.Z. për V.G. i datës 21.11.2023; E-mail nga G.S. për C.Z. i datës 07.12.2023; E-mail nga V.G. për K.L. i datës 06.12.2023; E-mail nga C.Z. për V.G. i datës 06.12.2023; Vendim i KPMSHCK me numër protokollit 7086/2023 i datës 24.11.2023; emial i datës 12.12.2023 nga KPSHCK për V. Gashi për sigurim të provave shtesë, email i datës 13.012.2023 nga V. Gashi për KPSHCK-ne së bashku me përshkrimet e detyrave të punës për të gjithë ankuesit si anëtar të Komisionit Qendror për vlerësimin e dëmeve.



Duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, Kolegji i Këshillit konstatoi së ankesa e ankuesve *është e bazuar, sepse:*

Nga shqyrtimi i shkresave të lëndës, rrjedhë se Qeveria e Republikës së Kosovës, me Vendimin më Nr.14/99 të datës 30.09.2022, ka themeluar Komisionin për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara në të mirat materiale nga ndikimi i fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera (në tekstin e mëtejme Komisioni Qendror për Vlerësimin e Dëmeve), në përbërje nga

Kryesuesi i Komisionit Qendror për Vlerësimin e Dëmeve, këtu ankuesi, Kastriot Lajçi me datë 25.04.2023, ka parashtruar kërkesë të Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Menaxhimit Emergjent lidhur me kompensimin për funksionin shtesë, ndërsa në mungesë të një përgjigjeje në kërkesën e datës 25.04.2023, parashtrojnë ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku ky i fundit me vendimin A.nr.1017/2023 të datës 08.09.2023, ka detyruar Drejtorin e Përgjithshëm të Agjencisë së Menaxhimit Emergjent që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi të nxjerrë akt administrativ në pajtim me legjislacioni në fuqi lidhur kërkesën e ankuesve të datës 25.04.2023.

Në zbatim të vendimit të Këshillit A.nr.1017/2023, Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Menaxhimit Emergjent me Vendimin numër Nr.164/2023 të datës 25.09.2023, ka refuzuar kërkesën e ankuesve për kompensim lidhur me funksionin shtesë .

Ankuesit serish parashtrojnë ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, duke kundërshtuar ligjshmërinë e Vendimit Nr.164/2023 të datës 25.09.2023 të Zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Menaxhimit Emergjent, me pretendimin së ankuesit si anëtarë të Komisionit Qendror për Vlerësimin e Dëmeve i themeluar sipas Vendimit nr.14/99 të datës 30.09.2022 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, kanë të drejtë në kompensimin për funksione shtesë siç përcaktohet me Rregulloren (QRK) Nr.10/2023 për Kompensimin për Funksionin Shtesë.

Në kuptim të së drejtës së nëpunësve civil në kompensim për funksion shtesë, Kolegji i Këshillit thekson faktin së kjo e drejtë njihet vetëm nga data e hyrjes në fuqi të Ligjit 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, përkatësisht nga data 05.02.2023 dhe me kushtin që janë përmbushur të gjitha kërkesat ligjore sipas këtij ligji si dhe akteve të nxjerra në zbatim të tij. Në këtë kontest Kolegji ju referua:

I. **Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik**, me theks neni 35 ka përcaktuar: *Kompensimet që mund të përfitohen në bazë të këtij ligji janë: 1.1. kompensimi për kujdestari; 1.2. kompensimi për punë gjatë natës dhe jashtë orarit të punës; 1.3. kompensimi për punë gjatë fundjavës dhe ditëve të festave zyrtare; 1.4. kompensimi për udhëtime dhe shpenzimet e përfaqësimit; 1.5. kompensimi për funksionin shtesë; 1.6. kompensimi për anëtarët/ët e shërbimit të jashtëm; dhe 1.7. kompensimi për stafin tjetër të administratës që punojnë jashtë vendit.* Ndërsa, neni 38 i po të njëjtit ligj ka rregulluar mënyra e përfitimit të kompensimit për funksion shtesë ku parashihet se: *1.Kur zyrtaret/ët publik, sipas legjislacionit në fuqi emërohen/caktohen që të*

shërbejnë në një bord, komision profesional apo organ tjetër publik që kërkon ekspertizë profesionale dhe përbën funksion shtesë për zyrtaren/in, ky/kjo zyrtar/e publik/e ka të drejtën e kompensimit shtesë për këtë funksion. 2. Kompensimi sipas pikës 1. të këtij neni nuk nënkupton detyrat dhe përgjegjësitë që rrjedhin nga pozita të cilën e mban zyrtarja/i publike, përfshirë këtu edhe pjesëmarrjen në komisione dhe/apo organe të tjera të themeluara brenda institucionit. 3. Kompensimi sipas këtij neni bëhet në masën tridhjetë për qind (30%) për kryetaren/in dhe njëzet për qind (20%) për anëtarët/ët, të pagës bazë së zyrtares/it kryesor administrativ të institucionit në të cilën themelohet bordi, komisioni profesional apo organi tjetër publik. 4. Kompensimi i parashikuar në këtë nen, në rastin kur bordi, komisioni profesional apo organi tjetër publik mblidhet së paku një (1) herë në muaj, përfitohet çdo muaj, me kusht pjesëmarrje në mbledhje. 5. Kompensimi i parashikuar në këtë nen, në rastin kur bordi, komisioni profesional apo organi tjetër publik mblidhet më rrallë se një (1) herë në muaj, kompensimi përfitohet për çdo mbledhje, me kusht pjesëmarrje në mbledhje. 6. Qeveria, me propozim të ministrisë përgjegjëse për administratë publike dhe pas pëlqimit nga ministria përgjegjëse për financa, me akt nënligjor miraton kriteret për përfitim të këtij kompensimi.

II. Rregullores (QRK) Nr. 10/2023 për Kompensimin për Funksione Shtesë, me theks nenit 4 paragrafin 1 dhe 2, ku përcaktohet se: *Kompensimi për funksionin shtesë 1. Zyrtari publik i cili emërohet/caktohet që të shërbejnë në një bord, komision profesional apo organ tjetër publik që kërkon ekspertizë profesionale dhe përbën funksion shtesë për këtë funksion. 2. Kompensimi sipas pikës 1 të këtij neni nuk nënkupton detyrat dhe përgjegjësitë që rrjedhin nga pozita të cilën e mban zyrtari publik, përfshirë këtu edhe pjesëmarrjen në komisione dhe/apo organe të tjera të themeluara brenda institucionit...*” nenit 5 paragrafi 2 ku parashihet se: 2. Përrjashtimisht, kompensimi për funksionin shtesë mund të përfitohet kur plotësohen në mënyrë kumulative kriteret e mëposhtme: 2.1. themelimi i Komisionit/Bordit parashihet në ligj apo akt nënligjor; 2.2. përfshirja në komision përbën funksion shtesë për zyrtarin publik; 2.3. funksioni nuk bënë pjesë tek detyrat e obligueshme të pozitës të cilën zyrtari publik e mbanë; 2.4. përfshirja në Komision kërkon ekspertizë profesionale të cilën zyrtari e posedon; 2.5. komisionet/bordet të cilat kanë kompetenca Vendim-marrëse në procedurë administrative; 2.6. komisioni/bordi nuk themelohet nga institucioni ku zyrtari publik është i punësuar...” si dhe nenit 7 ku përcaktohet se: 1. Kompensimi sipas këtij neni bëhet në masën tridhjetë për qind (30%) për kryetarin dhe njëzet për qind (20%) për anëtarët, të pagës bazë së zyrtarit kryesor administrativ të institucionit në të cilën themelohet bordi, komisioni profesional apo organi tjetër publik. 2. Kompensimi i parashikuar në këtë nen, në rastin kur bordi, komisioni profesional apo organi tjetër publik mblidhet së paku një (1) herë në muaj, përfitohet çdo muaj, me kusht pjesëmarrje në mbledhje. 3. Kompensimi i parashikuar në këtë nen, në rastin kur bordi, komisioni profesional apo organi tjetër publik mblidhet më rrallë se një (1) herë në muaj, kompensimi përfitohet për çdo mbledhje, me kusht pjesëmarrje në mbledhje.

III. Për me tepër, Kolegji mori parasysh edhe Qarkoren numër reference 355 të datës 22.03.202, të lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme lidhur me zbatimin e Rregullores (QRK) Nr.10/2023 për Kompensimin për Funksionin Shtesë, e me të cilën është përcaktuar se “... 3. Rregullorja ka përcaktuar kriteret për përfitim të këtij kompensimi, të cilat duhet të përmbushen në mënyrë kumulative: themelimi i Komisionit/Bordit parashihet në ligj apo akt nënligjor: 3.1 përfshirja në Komision përbën funksion shtesë për zyrtarin publik; 3.2 funksioni nuk bënë pjesë tek detyrat e obligueshme të pozitës të cilën zyrtari publik e mban; 3.3 përfshirja në Komision kërkon ekspertizë profesionale të cilën zyrtari e posedon;

3.4 Komisionet/Bordet të cilat kanë kompetenca vendimmarrëse në procedurë administrative; dhe,
3.5 Komisioni/Bordi nuk themelohet nga institucioni ku zyrtari publik është i punësuar...

8. Në rastet kur përbërja e Komisioni/Bordi është nga institucione të ndryshme, kryesuesi dhe të gjithë anëtarët e Komisionit/Bordit kanë të drejtë të kompensohen, duke përfshirë edhe anëtarët të cilët janë të punësuar në institucionin që ka nxjerrë vendimin për themelimin e Komisionit/Bordit. Kjo vlen për Komisionet/Borde që janë tërësisht ndryshe nga përshkrimi i detyrave të punës - si p.sh Komiteti i Auditimit të Brendshëm, Komisioni për Vlerësim të Dëmeve të Shkaktuara nga Fatkeqësitë Natyrore, Komisionet e ndryshme të themeluara nga Qeveria me përbërje të Institucioneve tjera. Ky kompensim nuk vlen për të gjitha Komisionet edhe sikur përbërja e tyre të jetë me zyrtarë të institucioneve të ndryshme, nëse në mënyrë kumulative nuk janë plotësuar kriteret e pikës 3. të kësaj Qarkore.

Procedura e kompensimit

9. Institucioni që themelon Bordin apo Komisionin sipas përcaktimeve të kësaj Rregulloreje, në Vendimin e themelimit parasheh të drejtën për kompensim të anëtarëve të Bordit apo Komisionit.
10. Kërkesa për kompensim nga kryesuesi i Komisionit/Bordit për të gjithë anëtarët, dërgohet tek Zyrtari më i Lartë Administrativ (ZKA) i Institucionit që ka nxjerrë vendimin.
11. Në rast të vendimeve të nxjerra nga Qeveria e Republikës së Kosovës, kompensimi bëhet nga organizata buxhetore që ka propozuar themelimin e Komisionit/Bordit.
12. ZKA, kërkesën e aprovuar e përcjell për ekzekutim të kompensimit për të gjithë anëtarët e Komisionit/Bordit, tek Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore e atij institucioni që ka nxjerrë vendimin për themelimin e Komisionit apo Bordit, respektivisht të Institucionit që ka propozuar themelimin e Komisionit/Bordit në rastin e vendimeve të nxjerra nga Qeveria.
13. Komisionet/Bordet që në vendimin për themelimin nuk e kanë të përcaktuar çështjen e kompensimit, duke përfshirë edhe ato që kanë qenë të themeluara në momentin e hyrjes në fuqi të Rregullores (QRK) Nr. 10/2023, kërkesën e arsyetuar me shkrim për kompensim e dërgojnë për aprovim tek ZKA i institucionit që ka nxjerrë vendimin për themelimin e Komisionit/Bordit.
14. ZKA i Institucionit pas pranimit të kërkesës sipas pikës 9. të kësaj Qarkoreje, e shqyrton kërkesën dhe vendos për aprovim nëse Komisioni/Bordi plotëson kriteret e përcaktuara në Rregulloren (QRK) Nr. 10/2023. Në të kundërt, ZKA nxjerr vendim me shkrim për refuzim të kërkesës, në rast se konsideron se kriteret e Rregullores (QRK) Nr. 10/2023 nuk janë përmbushur.
15. Në rastet kur ZKA aprovon kërkesën sipas pikës 9. të kësaj Qarkoreje, kërkesën për ekzekutim të kompensimit për të gjithë anëtarët e Komisioni/Bordit, e përcjell tek Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Institucionit që ka nxjerrë vendimin për themelimin e Komisionit/Bordit, respektivisht të Institucionit që ka propozuar themelimin e Komisionit/Bordit në rastin e vendimeve të nxjerra nga Qeveria.
16. Kryesuesi i Komisionit/Bordit që kompensohet sipas Rregullores (QRK) Nr. 10/2023, dhe që mbledhet të paktën një (1) herë në muaj, në fillim të çdo muaji përcjell listën e pjesëmarrjes në takime të Komisionit/Bordit tek ZKA i Institucionit që ka nxjerrë vendimin për themelimin të Komisionit/Bordit. Në rast se Komisioni/Bordi mbledhet më rrallë se një (1) herë në muaj, Kryesuesi e përcjell listën e pjesëmarrjes sipas pikës 12. të kësaj Qarkoreje, çdo herë pas mbledhjes së Komisionit/Bordit

Nisur nga kuadri ligjor si me lart si dhe duke u bazuar në provat materiale të çështjes, Kolegji vlerëson së janë të bazuara pretendimet ankimore të ankuesve për kompensim të funksionit shtesë sipas vendimit Nr.14/99 të datës 30.09.2023 të Qeverisë së Kosovës, për faktin se në rastin e ankuesve janë plotësuar të gjitha kërkesat ligjore të përcaktuara me dispozitat ligjore referuar kompensimeve për funksione shtesë, rrjedhimisht, themelimi i Komisionit Qendror për vlerësimin e dëmeve është përcaktuar me nenin 90 të Ligjit Nr.04/L-027 për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera si dhe nenin 8 paragrafi 2 nën paragrafi 2.1 të Rregullores (QRK) Nr.17/2015 për Metodologjinë e vlerësimit të dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera. Tutje, nga analizimi i përshkrimit të detyrave të punës së ankuesve, rrjedhë së funksioni shtesë lidhur me

angazhimin e tyre si anëtarë të Komisionit Qendror për vlerësimin e dëmeve, nuk bënë pjesë të detyrat e obligueshme të ankuesve dhe se në mbështetje të dispozitave të nenit 13 të Rregullores (QRK) Nr.17/2015 për Metodologjinë e vlerësimit të dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, Komisioni Qendror për vlerësimin e dëmeve, përveç kompetencës së monitorimit, drejtimit dhe këshillimit të komisioneve lokale për vlerësimin e dëmeve, ka edhe kompetencë të vendimmarrjes, për faktin së i njëjti bën verifikimin e vërtetësisë së dëmeve të vlerësuara nga komisionet lokale me ekzaminimin e dokumentacionit dhe gjendjes reale të dëmeve të shkaktuar si dhe përgatitë raportin përfundimtar përmbledhës për dëmet e vlerësuara në tërë territorin e Republikës së Kosovës, i cili miratohet në Qeveri dhe mbi bazën e këtij raporti realizohet kompensimi i dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera.

Përkitazi me kriterin që anëtarët e Komisionit Qendror për vlerësimin e dëmeve duhet të jenë zyrtarë që posedojnë ekspertizë profesionale, Kolegji e konsideroj si kriter të përmbushur, nisur nga fakti se institucionet kanë për obligim ligjor që të caktojnë zyrtarë me ekspertizë përkatëse, ndërsa, është përgjegjësi e Qeverisë së Kosovës që të përkujdeset se kjo kërkesë është respektuar nga institucionet gjegjëse.

Kolegji nga shkresat e lëndës ka gjetur se institucion propozues për themelimin e Komisionit Qendror për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera është Ministria e Punëve të Brendshme, kurse anëtarë të këtij komisioni janë zyrtarë të punësuar në institucione të ndryshme si Agjencia e Statistikave të Kosovës, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Ministria e Pushtetit Lokal, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Ekonomisë, Ministria e Punëve të Brendshme dhe Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, andaj, siç edhe është përcaktuar edhe në pikën 8 dhe 11 të Qarkores lidhur me zbatimin e Rregullores (QRK) Nr.10/2023 për Kompensimin për Funkcionin shtesë, edhe pse vendimi për themelimin e këtij komisioni është nxjerrë nga Qeveria e Kosovës, detyrimi i kompensimit të anëtareve bie mbi institucionin që ka propozuar themelimin e komisionit dhe së e drejta e kompensimit vlen për të gjithë anëtarët, përfshirë edhe anëtarët që janë të punësuar në institucionin që ka propozuar themelimin e komisionit, në këtë rast MPB.

Kolegji i Këshillit lidhur me këtë çështje juridiko administrative sjell në vëmendje faktin se në rastet kur një e drejtë e nëpunësit civil buron nga legjislacioni i aplikueshëm, kjo e drejtë është e zbatueshme edhe në rastet kur akti administrativ mbi themelimin e komisionit përkatës nuk përmban klauzolën mbi kompensimin, fakt ky i përcaktuar edhe me pikën 13 të Qarkores me numër reference 355 të datës 22.03.2023 lidhur me zbatimin e Rregullores (QRK) Nr.10/2023 për Kompensimin për Funkcionin Shtesë.

Andaj, bazuar në konstatimet e lart cekura, Kolegji në mbështetje të nenit 18 paragrafit 1 nën paragrafit 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 53 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi që të aprovoj në tërësi si të bazuar aneksen e ankuesve, duke obliguar Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme, që në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi, ankuesve si në pikën I të dispozitivit, t'i u njoh të drejtën e kompensimit për funksionin shtesë lidhur me angazhimin në Komisionin Qendror për Vlerësimin e Dëmeve, i themeluar sipas Vendimit Nr.14/99 të datës 30.09.2023 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, si dhe t'iu bëjë kompensimin për funksion shtesë në mënyrë retroaktive nga data

06.02.2023, pra nga data e hyrjes në fuqi të Rregullores (QRK) Nr.10/2023 për Kompensimin për Funksione Shtesë.

Këshillë juridike: *Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1283/2023

Çlirim Zeka

Çlirim Zeka
Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj Demi

Ardita Haxhnikaj Demi
Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm të MPB-së;
- Drejtorit të Përgjithshëm të AME-së;
- Arkivit të KPMSHCK-së.